

PROGRAMI “PAS SHKOLLE”

NJOFTIM PËR PRINDËRIT

ZVAP Rrogozhinë informon prindërit dhe komunitetin se, në kuadër të zbatimit të Programit “Pas Shkolle” për vitin shkollor 2026–2027, në këtë program janë përfshirë këto institucione arsimore:

☐ **Shkolla 9-vjeçare “Xhorxh Soros”**

☐ **Shkolla 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”**

☐ **SHB Gosë**

☐ **Gjimnazi “Haxhi Qehaj”**

Programi “Pas Shkolle” synon t’u ofrojë nxënësve, përtej orarit të detyruar mësimor, mundësi për të zhvilluar aftësitë, talentet dhe interesat e tyre, përmes veprimtarive të larmishme edukative, krijuese, kulturore dhe sociale.

☐☐☐☐ Ftojme prindërit/kujdestarët ligjorë të nxënësve të interesuar të kontaktojnë institucionin arsimor përkatës për t’u informuar mbi organizimin e programit, aktivitetet që do të ofrohen, oraret dhe mënyrën e përfshirjes së fëmijëve të tyre.

☐ Për SHB Gosë dhe gjimnazin “Haxhi Qehaj”, në kuadër të programit do të ofrohet edhe komponenti “Art dhe Zeje”, duke krijuar mundësi për zhvillimin e aftësive krijuese dhe artistike të nxënësve.

Programi “Pas Shkolle” synon të krijojë një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues, ku nxënësit të mësojnë, të bashkëpunojnë, të krijojnë dhe të zhvillojnë potencialin e tyre.

☐ **Për informacion më të detajuar dhe për të shprehur interesin për pjesëmarrje, prindërit mund t’i drejtohen shkollës përkatëse.**

ZVAP Rrogozhinë

Bashkë për një shkollë që ofron më shumë mundësi për çdo nxënës!